



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 1200/Prot  
1

Tiranë, më 09/12 / 2015

**Lënda:** Jepet mendim mbi Projektligjin "Për regjistrimin e adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë"

**Drejtuar:** Z. Saimir TAHIRI  
MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME

**TIRANË**

I nderuar z.Tahiri,

Në përgjigje të shkresës Tuaj Nr.8755 Prot, datë 24.11.2015, projektligji "Për regjistrimin e adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë", vlerësohet i hartuar konform kërkesave të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

Ndërkohë, sugjerojmë që në nenin 5 të shtohet një pikë me përmbajtje, "Procesi i përpunimit të të dhënave personale të këtyre shtetasve, duke nisur nga momenti i identifikimit, vetëdeklarimit dhe hedhjes së të dhënave në sistemin e rregjistrimit të adresave, do të kryhet në përputhje me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe detyrimet e parashikuara në legjislacionin e mbrojtjes së të dhënave personale".

Gjithashtu, në nenin 6 pas pikës 1 të shtohet një pikë me përmbajtje, "Shtetasi informohet, nëpërmjet faqes zyrtare të autoriteteve përgjegjëse dhe formularit tip të vetëdeklarimit, mbi qëllimin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale, mënyrën e përpunimit, masat e sigurisë teknike dhe fizike, afatin e mbajtjes së të dhënave dhe të drejtat që gëzon si subjekt i të dhënave personale."

Në përfundim, sugjerimet e dhëna ndër të tjera kushtëzojnë përmbajtjen e formularit të vetëdeklarimit në mbledhjen e të dhënave. Kjo do të thotë që sasia e të dhënave që do të mblidhet në këtë formular nuk duhet të tejkalojë qëllimin e përcaktuar në këtë projektligj.

Për të parë qasjen e kësaj përputhshmërie nevojitet që projektaktet nënligjore të përcaktuara në pikën 2 të nenit 5 dhe në pikën 3 të nenit 6 të këtij projektligji, të cilat do të hartohen dhe dalin në zbatim të tij, të adresohet për mendim edhe pranë Zyrës së Komisionerit.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

